



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.151

12 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 333 datë 14.10.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, për vitin 2009, të komponentit të dytë të Instrumentit të Ndhmës së Paraaderimit (IPA) - Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë” 8021
Ligj nr.10 334 datë 14.10.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin ndërkufitar Shqipëri - ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, për vitin 2009, të komponentit të dytë të Instrumentit të Ndhmës së Paraaderimit (IPA) - Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë” 8037
Vendim i KM nr.818, datë 13.10.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.1691, datë 10.10.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektët në qarqe dhe administratën e prefektëve, nënprefektët dhe administratën e nënprefektëve dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtorisë së PMNZSH-së)” 8054
Vendim i KM nr.819, datë 13.10.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi i bllokut nr. 2, në bashkinë e Delvinës..... 8055
Vendim i KM nr.820, datë 13.10.2010	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit..... 8056

LIGJ
Nr.10 333, datë 14.10.2010

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE
EUROPIANE “PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR NDËRMJET SHQIPËRISË DHE
MALIT TË ZI, PËR VITIN 2009, TË KOMPLEMENTIT TË DYTË TË INSTRUMENTIT TË
NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA) - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR PËR
SHQIPËRINË””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, për vitin 2009, të komponentit të dytë të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA) - Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6739, datë 21.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE FINANCIMI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN NDËRKUFITAR
SHQIPËRI-MAL I ZI NËN KOMPLEMENTIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR TË
INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAADERIMIT (IPA) PËR VITIN 2009**

(Menaxhimi i centralizuar)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si “Palët” ose individualisht si “Vendi përfitues” në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose “Komisioni”, në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

duke pasur parasysh se:

a) Më 1 gusht 2006, Këshilli i Bashkimit Europian vendosi me anë të rregullores (EC) nr.1085/2006 krijimin e një instrumenti të asistencës për paraaderimin (këtej e tutje “Rregullorja kuadër IPA”). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet kandidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet kandidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën, sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t’u bërë një ditë anëtare të Bashkimit Europian.

b) Më 12 qershor 2007, Komisioni vendosi me anë të rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje “Rregullorja e zbatimit IPA”).

c) Asistenca komunitare nën instrumentin e asistencës së paraaderimit duhet të vazhdojë të mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë.

Për vendet potenciale kandidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural.

d) Palët kanë nënshkruar më 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën instrumentin e paraaderimit.

e) Programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi për vitet 2007-2009 u miratua nga Komisioni me vendimin C(2007)6342 të datës 18 dhjetor 2007.

f) Komisioni, më datë 21 gusht 2009, miratoi propozimin financiar për vitin 2009, të programit ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi (këtej e tutje “Programi”). Ky program do të implementohet në mënyrë të centralizuar nga Komisioni.

g) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që Palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve, sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë.

Kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. PROGRAMI

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: 2009/021-165 (CRIS) [Pjesa e Shqipërisë]; 2009/021-595 [Pjesa e Malit të Zi]

Titulli: Programi ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA për vitin 2009.

2. ZBATIMI I PROGRAMIT

1. Programi do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve, të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të datës 13 dhjetor 2006 (këtej e tutje “Rregullorja financiare”).

2. Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kuadër mbi rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet Palëve më 18 tetor 2007 (këtej e tutje “Marrëveshja kuadër”), e cila ndodhet në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. STRUKTURAT DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA në përputhje me marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfituesit përballë Komisionit. Ai/ajo duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së së paraaderimit nën instrumentin IPA-në.

2. Koordinator kombëtar IPA do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet që përfshijnë vende që lagen nga dete, nën instrumente të tjera të Komunitetit.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese për pjesën e programit në territorin e vet. Funkcionet dhe përgjegjësitë e tij përcaktohen në programin ndërkufitar, me përjashtim të tenderimit, kontraktimit dhe pagesave, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. Struktura operuese duhet të bashkëpunojë ngushtë me strukturën operuese të Malit të Zi për implementimin e këtij programi.

5. Sipas nenit 142 të rregullores së zbatimit IPA, strukturat operuese të vendeve pjesëmarrëse duhet të ngrenë një Sekretariat të Përbashkët Teknik për të asistuar strukturat operuese dhe Komitetin e Përbashkët Monitorues në përmbushjen e detyrave të tyre respektive.

Sekretariati i Përbashkët Teknik mund të ketë antenë të ngritur në secilin vend pjesëmarrës.

4. FINANCIMI

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2009 është përcaktuar në një maksimum prej 850,000 €, siç detajohet në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Kostoja e strukturave dhe autoriteteve të ngritura nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi do të mbulohet nga Përfituesi, me përjashtim të kostove referuar në nenin 94(1)(f) të rregullores së zbatimit IPA.

5. AFATI PËRFUNDIMTAR PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale, të cilat zbatojnë këtë Marrëveshje do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit së tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit të përfundimit të tij, do të anulohet.

6. AFATI PËR EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i zbatimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. AFATI I DISBURSIMIT

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data përfundimtare e ekzekutimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të saj.

8. TRAJTIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat, në kuadër të IPA-së përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose të ardhura të tjera ekuivalente me përjashtim të:

a) të ardhurave të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimeve në firma;

b) të ardhurave të nxjerra brenda kuadrit të një mase inxhinierie financiare, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributet nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Të ardhurat siç përkufizohen në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura, të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit, këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme relevante për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionale, në varësi të asaj, nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. SHPENZIMET E LEJUESHME

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

- a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH);
- b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;
- c) blerjet, dhëniet me qira ose me kredi të truallit dhe godinave ekzistuese;
- d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- e) kostot operacionale;
- f) pajisje të dorës së dytë;
- g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;
- h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;
- i) kontribute në natyrë;
- j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

- a) taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:
 - i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre,
 - ii) është përcaktuar që ato janë kryer nga përfituesi i fundit, dhe
 - iii) janë të identifikuar qartë në projektpropozim.
- b) detyrimet për transaksione financiare transnacionale;
- c) në rast se zbatimi i një aktiviteti kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;
- d) kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me aktivitetin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;
- e) kostot e garancisë, të siguruar nga një bankë ose institucione të tjera financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit;
- f) shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkte të një aktiviteti, i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Për llogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht;
- g) blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit respektiv.

4. Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme, të paguara nga autoritete publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:

- a) kostot e shërbimeve të specializuara, të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi i fundit gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti;
- b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti, të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi i fundit që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjera nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht ose direkt për aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'ia ngarkojnë kostot e referuara në pikën "a" të këtij paragrafi përfituesve përfundimtarë ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale, të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.

Kostot e referuara në pikën "b" të këtij paragrafi, duhet të jenë të certifikuara me anë të dokumenteve, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë aktivitet.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programin ndërkuftar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

10. RUAJTJA E DOKUMENTEVE

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti European mbyll vitin buxhetor, të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit, i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. PLANI PËR DECENTRALIZIMIN PA KONTROLLE *EX-ANTE*

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex-ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan indikativ për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1 dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipat e ndryshëm të kontrolleve *ex-ante*.

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. INTERPRETIMI

1. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të ruajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshje shprehet ndryshe, referencat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë referencat e kësaj Marrëveshjeje, të ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të zhvendosen në këtë Marrëveshje me anë të amendimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë interpretimin e saj.

13. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME DHE BOSHLLËQET E PAQËLLIMSHME

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshje përmban boshllëqe të paqëllimshme, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të mbushin çdo boshllëk të paqëllimshëm nëpërmjet një dispozite, e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë të rëna dakord ndërmjet Palëve.

2. Çdo ndryshim për të cilin është rënë dakord ndërmjet Palëve do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshime të tilla do të hyjnë në fuqi pasi vendosen ndërmjet Palëve.

15. PËRFUNDIMI

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë, duke informuar me shkrim Palën tjetër. Ky përfundim do të ketë efekt gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Mosmarrëveshjet që dalin nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen miqësisht nëpërmjet konsultimit mes Palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila Palë mund ta çojë çështjen për gjykim në përputhje me rregullat fakultative të gjykimit të Gjykatës së Përhershme për Gjykimet që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë gjuha angleze. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Gjykimit, pas një kërkesë me shkrim, të dërguar nga cilado nga Palët. Vendimi i arbitrit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelues.

17. NJOFTIME

1. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:
Z. Helmuth Lohan
Shef i delegacionit
Delegacioni i Komisionit Europian në Shqipëri
Qendra e biznesit "ABA", kati i 17-të
Rruga: "Papa Gjon Pali II"
Tiranë, Shqipëri
Fax: + 355 4230752

Për vendin përfitues
Znj. Majlinda Bregu
Ministre e Integritimit Europian
Rruga: "Papa Gjon Pali II", nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Fax +355 4256267

18. NUMRI I ORIGJINALEVE

Marrëveshja e financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. SHTOJCAT

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala e dytë.

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë
në datë

nga

Znj. Majlinda Bregu
Ministre e Integritimit Europian

Firmosur, për dhe në emër të Komisionit, në Tiranë në datë

nga

Z. Helmuth Lohan
Shef i delegacionit të Komisionit Europian

ANEKSI A
PROGRAMI NDËRKUFITAR NDËRMJET SHQIPËRISË DHE MALIT TË ZI
NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA PËR VITIN 2009

SHTOJCA A1
PROPOZIMI I FINANCIMIT PËR VITIN 2009 PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI-
MALI I ZI, MIRATUAR ME VENDIM TË KOMISIONIT C(2009)6445
NË DATË 21 GUSHT 2009

SHTOJCA A2
PROGRAMI NDËRKUFITAR SHQIPËRI-MALI I ZI 2007-2009 IPA CBC, SHQIPËRI-MALI
I ZI, MIRATUAR ME VENDIM TË KOMISIONIT C(2007)6342 NË DATË 18 DHJETOR 2007

ANEKSI B
MARRËVESHJA KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DATË 18 TETOR 2007

ANEKSI C
RAPORTIMI

1. Strukturat operuese të vendeve përfituese në një program ndërkufitar duhet t'i dërgojnë Komisionit dhe koordinatorëve kombëtarë respektivë IPA një raport vjetor dhe një raport përfundimtar mbi zbatimin e programit ndërkufitar pas kontrollit të tyre nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason miratimin e programit ndërkufitar.

Raporti përfundimtar duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) Progresin e bërë gjatë zbatimit të programit ndërkufitar dhe prioritetet në raport me qëllimet specifike, të verifikueshme, me një përcaktim sasior të sasisë, kurdo dhe kudo që kjo të jetë e mundur, duke përdorur indikatorët në nenin 94 (1) "d" të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akseve prioritare;

b) Hapat e ndërmarrë nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave,

- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme, të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo mase të marrë;

- përdorimin e asistencës teknike;

c) Masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat "a" deri në "c" të këtij paragrafi mund të jepet në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën "b" të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

VENDIM I KOMISIONIT
C(2009) 6445 I DATËS 21 GUSHT 2009
PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR SHQIPËRI – MAL I
ZI NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA, PËR VITIN 2009

Komisioni i Komuniteteve Europiane:

duke pasur parasysh traktatin themelues të Komunitetit Europian,
duke pasur parasysh rregulloren e Këshillit (KE) nr.1085/2006 të datës 17 korrik 2006, që krijon Instrumentin e Ndhmës së Paraaderimit (IPA)¹ dhe veçanërisht nenin 14, pika 2, shkronja “a” të saj,

Meqë:

1. Rregullorja (KE) nr.1085/2006 përcakton objektivat dhe parimet kryesore për asistencën e paraaderimit për vendet candidate dhe candidate potenciale.

2. Në përputhje me nenin 7, pika 1 të rregullores së Këshillit (KE) nr.1085/2006, asistenca duhet të jepet nëpërmjet programeve vjetore ose shumëvjeçare, për vend, grup vendesh ose komponentë. Këto programe duhet të hartohen në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të politikës siç përcaktohet në nenin 4 të rregullores nr.1085/2006 dhe dokumentet planifikuese indikative shumëvjeçare përkatëse, të referuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli ka vendosur një partneritet europian për Shqipërinë² dhe një partneritet europian për Malin e Zi³ në datë 29 shtator 2008, Komisioni miratoi Dokumentin planifikues indikativ shumëvjeçar 2008-2010 për Shqipërinë dhe në datë 4 gusht 2008, Dokumentin planifikues indikativ shumëvjeçar 2008-2010 për Malin e Zi, të cilat përmbledhin prioritetet kryesore për ndihmën e paraaderimit për këto vende⁴.

4. Në përputhje me nenin 91 të rregullores së Komisionit (KE) nr.718/2007 të datës 12 qershor 2007, që zbaton rregulloren e Këshillit (KE) 1085/2006 dhe siç parashikohet, e cila krijon Instrumentin e Ndhmës së Paraaderimit (IPA)⁵ (këtëj e tutje referuar “Rregullorja e zbatimit IPA”), Komisioni miratoi më 18 dhjetor 2007 programin ndërkufitar shumëvjeçar Shqipëri-Mal i Zi 2007-2009 (vendimi C(2007)6342).

5. Programi ndërkufitar shumëvjeçar Shqipëri-Mal i Zi ka për qëllim të sigurojë asistencë për promovimin e bashkëpunimit midis njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve dhe të nxitë zhvillimin e qëndrueshëm dhe stabilitetin e zonave kufitare. Prioriteti i parë do të mbështesë zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social ndërkufitar, ndërsa prioriteti i dytë do të sigurojë asistencë teknike për të implementuar programin.

6. Programi ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi për vitin 2007, u implementua nëpërmjet vendimit të financimit C(2007)6342 të datës 18 dhjetor 2007 dhe për vitin 2008 nëpërmjet vendimit të financimit C(2008)3825 të datës 25 korrik 2008. Një vendim i ri financimi duhet të miratohet për të implementuar programin e vitit 2009.

7. Për vitin 2009, ky vendim plotëson kërkesat e nenit 90 të rregullores së Komisionit (KE, Euroatom) nr.2342/2002 të datës 23 dhjetor 2002, e cila përcakton rregullat e detajuara për implementimin e rregullores së Këshillit nr.1605/2002⁶, duke qenë kështu një vendim financimi sipas kuptimit të nenit 75 (2) të rregullores së Këshillit nr.1605/2002 të datës 25 qershor 2002 të rregullores financiare, të aplikuar për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane⁷.

8. Masat e parashikuara në këtë vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit IPA, ka vendosur si më poshtë:

¹ GZ L 210, 31.7.2006, faqe 82.

² Vendim i Këshillit 2008/210/KE i datës 18 shkurt 2008, GZ L 80, 19.3.2006, faqe 1-17.

³ Vendim i Këshillit 2007/49/KE i datës 22 janar 2007, GZ L 20, 27.1.2007, faqe 16-31.

⁴ Për Shqipërinë: C(2008)5352; për Malin e Zi: C(2008)4275.

⁵ GZ L 170, 29.6.2007, faqe 1.

⁶ GZ L 357, 31.12.2002, faqe 1.

⁷ GZ L 248, 16.9.2002, faqe 1.

Neni 1

Miratohet propozimi i financimit për vitin 2009 të “Programit ndërkufitar Shqipëri-Mal i Zi”, siç përcaktohet në shtojcën e këtij vendimi. Ky program do të zbatohet në mënyrë të centralizuar.

Ky program që i korrespondon vitit buxhetor 2009 do të zbatohet nëpërmjet marrëveshjes së financimit që do të nënshkruhet midis Komisionit dhe Këshillit të Ministrave të secilit prej vendeve pjesëmarrëse në përputhje me marrëveshjen kuadër, të nënshkruar midis palëve të njëjta në datë 18 tetor 2007 për Shqipërinë dhe 15 nëntor 2007 për Malin e Zi. Secila nga marrëveshjet e financimit do të mbulojë kontributin e Komisionit për vendin përfitues për vitin në fjalë.

Neni 2

Shuma maksimale e kontributit të Komunitetit do të jetë 850.000 euro për Shqipërinë dhe 600.000 euro për Malin e Zi, dhënë nga zëri 22.020401 i buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane për vitin 2009.

Nënshkruar në Bruksel,

PËR KOMISIONIN
Olli Rehn
Anëtar i Komisionit

SHTOJCË PROPOZIMI FINANCIAR PËR VITIN 2009 PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI- MAL I ZI

1. IDENTIFIKIMI

Përfituesit	Shqipëria dhe Mali i Zi
Numri CRIS	2009/021-165, 2009/021-595
Viti	2009
Kosto	Shqipëria: 850,000 € Mali i Zi: 600,000 € Vlera totale e kontributit IPA: 1,45 milionë €
Strukturat operuese	Në Shqipëri: Ministria e Integritimit European Në Mal të Zi: Sekretariati për Integrimin European
Autoritetet implementuese	Për Shqipërinë/ Malin e Zi: Komisioni European
Data përfundimtare për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Financimit	Maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2010
Data përfundimtare për nënshkrimin e kontratave	2 vjet që nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit. Nuk ka afat për projektet e auditimit dhe vlerësimit që mbuloohen nga kjo marrëveshje financimi, duke iu referuar nenit 166(2) të rregullores financiare. Këto data vlejné edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes	2 vjet nga data përfundimtare e nënshkrimit të kontratave. Këto data vlejné edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Kodi i sektorit	11120, 14010, 16061, 33210, 41010, 43040, 91010
Zëri buxhetor përkatës	22.02.04.01
Menaxheri përgjegjës i programimit	Për Shqipërinë: Drejtorja e Përgjithshme e Zgjerimit, Njësia C4 Për Malin e Zi: Drejtorja e Përgjithshme e Zgjerimit, Njësia C2
Menaxheri përgjegjës i zbatimit	Seksionet operacionale të delegacioneve të KE-së në Shqipëri dhe Mal të Zi

2. PËRMBLEDHJE

2.1 Hyrje

Lidhja me MIPD

Programi ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi do të kontribuojë në implementimin e Komponentit II të instrumentit IPA "Bashkëpunimi ndërkufitar" të dokumenteve indikative shumëvjeçare të planifikimit (MIPDs) 2008-2010 për të dyja vendet. Ky program do të sigurojë asistencë për "Stabilizimin demokratik dhe ngritjen e kapaciteteve administrative", "Zhvillimin ekonomik dhe social", "Infrastrukturën" dhe "Asistencën teknike", të identifikuar si fusha madhore të ndërhyrjes në MIPD-në për Shqipërinë dhe do të adresojë nevojën për "zhvillimin e aktiviteteve ndërkufitare në fushën ekonomike, sociale dhe mjedisore të zonave kufitare", për të "adresuar sfidat e përbashkëta në veçanti në fushat e mjedisit dhe shëndetit publik dhe zhvillimi", si dhe për të "promovuar aktivitetet lokale "njerëzit për njerëzit", duke përfshirë OJQ-të dhe autoritetet lokale", të identifikuar në MIPD-në për Malin e Zi.

- Procesi i programimit

Programimi u krye nga janari deri në maj 2007. Programi u hartua nëpërmjet një procesi të gjerë konsultimesh me aktorët lokalë dhe përfituesit potencialë në të dyja anët e kufirit. Autoritetet kombëtare dhe strukturat e përbashkëta u asistuan gjatë këtij procesi nga projekti Ngritja e Kapaciteteve të Institucioneve Ndërkufitare (CBIB) financuar nga programi rajonal CARDS 2003. Ai u koordinua në secilin vend nga koordinatorët respektivë ndërkufitar: Ministria e Integritit European në Shqipëri dhe Sekretariati për Integritit European në Mal të Zi.

Në janar 2007 secili vend ngriti strukturat operuese (SO), të ngarkuara me përgatitjen e programeve ndërkufitare. Komiteti i Përbashkët i Programimit, i cili konsistonte në anëtarë të SO, u ngrit, gjithashtu, në janar 2007. Strukturat operuese u takuan në datë 14 shkurt 2007, me qëllim identifikimin e institucioneve përgjegjëse për përgatitjen e programeve ndërkufitare zhvillimin e një plan veprimi paraprak. Komiteti i Përbashkët i Programimit u takua më datë 26 shkurt 2007 dhe ra dakord mbi zonat përfituese dhe planin e veprimit.

Gjatë muajit mars dhe prill 2007, aktorët kryesorë u konsultuan dhe strukturat operuese u takuan disa herë për të diskutuar analizën e rajonit ndërkufitar dhe SWOT dhe për të identifikuar prioritetet dhe masat. Komiteti i Përbashkët i Programimit u mbledh në datë 17 prill 2007 për të rënë dakord mbi shtrirjen e rajonit ndërkufitar përfitues dhe analizën SWOT, si dhe të diskutonin prioritetet dhe masat. Komiteti u mbledh serish në datë 23 maj 2007 për të aprovuar draftin e programit ndërkufitar.

- Lista e zonave përfituese

Zonat përfituese në Shqipëri janë dy qarqe ekuivalente me nivelin NUTS III: qarku Shkodër dhe qarku Kukës.

Mali i Zi është i ndarë në 21 bashki, të cilat janë njësitë bazë të vetëqeverisjes. Territori përfitues i Malit të Zi mbulon një hapësirë prej 9 bashki: Budva, Berane, Andrijevica, Plav, Danilovgrad, Podgorica, Bar, Ulcinj, Cetinje.

- Zona shtesë (në përputhje me nenin 97 të rregullores së implementimit IPA)

Mal të Zi ka një zonë të shtuar: bashkia Rozhaje.

	Sip. km ²	Popullsia
Rajoni ndërkufitar i Shqipërisë	5,936	337,247
Rajoni ndërkufitar i Malit të Zi (totali i zonave përfituese dhe shtesë)	5,745	357,654
Rajoni ndërkufitar në total	11,681	694,901

Territori i zonave përfituese është pothuajse i njëjtë në secilin vend, dhe popullsia është shumë e balancuar.

2.2 Objektivi global i programit

Objektivi global i këtij programi është të promovojë bashkëpunimin midis njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve në zonat kufitare, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin dhe prosperitetin e këtyre zonave me interes reciprok për qytetarët e të dyja vendeve. Ky program do të ketë efekte të një katalizatori meqë ka si synim të ndërtojë kapacitetet e aktorëve lokalë, bashkive, institucioneve rajonale dhe shoqërisë civile, dhe si rrjedhim aftësinë e tyre për të marrë pjesë në iniciativa ndërkufitare.

2.3.1. Akset prioritare, masat respektive dhe aspektet e tyre në lidhje me implementimin e buxhetit të vitit 2009

2.3.1. Aksi prioritar I: Promovimi i kohezionit rajonal dhe konkurrueshmërisë nëpërmjet një përqaasjeje që integron zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social

Ky prioritet do të kontribuojë në cilësinë e standardeve të jetesës në zonën e programimit duke ofruar mundësi për partneritet ekonomik dhe shkëmbim të interesave të përbashkëta përgjatë zonës. Aktivitetet që do të implementohen pritet të rritin cilësinë e shërbimeve, të gjenerojnë mundësi punësimi dhe sipërmarrjeje, të përmirësojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të nxitin shkëmbimet kulturore. Ato do të lehtësojnë, gjithashtu, forcimin e komuniteteve lokale dhe organizatat e shoqërisë civile dhe promovojnë kohezionin social.

Ky prioritet konsiston në 3 masa specifike.

Masa I.1: Zhvillimi ekonomik me fokus te turizmi

Objektivi specifik i kësaj mase është të promovojë zhvillimin ekonomik të zonës së programimit, bazuar në potencialet e tyre turistike dhe kulturore. Rezultatet e pritshme janë menaxhimi i përbashkët i aktiviteteve turistike dhe rritja e cilësisë së shërbimeve, konkurrueshmërisë dhe atraktivitetit të sektorit të turizmit.

Kjo masë do të inkurajojë iniciativa për të modernizuar shërbimet turistike duke zhvilluar shërbime të përbashkëta këshilluese për biznesin dhe duke stimuluar ndërveprimin e rregullt midis bizneseve të vendosura përgjatë rajonit ndërkufitar, nëpërmjet: rrjeteve bizneset-për-bizneset; marketingut të përbashkët në tregjet e brendshme dhe atë të BE-së; bashkëpunimit të organizatave të edukimit për shërbimet e inovacionit dhe formimit profesional; investimeve të përzgjedhura në infrastrukturën e biznesit; promovimi i imazhit të zonës ndaj investuesve dhe vizitorëve potencialë.

Masa I.2: Mbrojtja dhe promovimi i mjedisit

Objektivi specifik i kësaj mase është të mbështesë iniciativat e përbashkëta me qëllim mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e ekosistemeve të ndjeshme dhe zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor të zonës së programimit. Rezultatet që priten janë menaxhimi i përbashkët i zonave të mbrojtura dhe rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë rreth çështjeve të mjedisit.

Kjo masë do të mbështesë bashkëpunimin midis organizatave të mbrojtjes së mjedisit, aktive në zonën e programimit për të përgatitur dhe implementuar plane menaxhimi për zonat e ekoturizmit, me fokus kryesor në liqenin e Shkodrës/Skadar dhe rrethinat e tij.

Masa I.3: Rritja e kohezionit social nëpërmjet aktiviteteve “Njerëzit për njerëzit”

Objektivi specifik i kësaj mase është të inkurajojë qytetarët e zonës së programimit të përfshihen në një rang të gjerë mundësish për bashkëpunim dhe ngritje partneritetesh dhe do të rezultojë në ngritjen e rrjeteve të reja dhe shkëmbime midis aktorëve lokalë.

Aktivitetet “njerëzit për njerëzit” pritet të rritin në mënyrë direkte rrjedhën e informacionit dhe komunikimit përgjatë zonës kufitare. Aktivitetet e parashikuara nën këtë masë do t'i sjellin njerëzit, komunitetet lokale dhe shoqërinë civile të zonës kufitare pranë njëri-tjetrit, p.sh., mbështetje për shkëmbimet kulturore, promovimi i punimeve artizanale, prodhimeve tradicionale dhe trashëgimisë lokale.

Aktivitetet “Njerëzit për njerëzit” do të financohen edhe nga masat I.1 dhe I.2. Harmonizimi midis këtyre tri masave do të sigurohet.

2.3.2. Aksi prioritar II: Asistencë teknike për një menaxhim efikas të programit dhe rrjedhës së informacionit

Asistenca teknike do të sigurohet nëpërmjet dy masave.

Masa II.1: Administrimi, monitorimi dhe vlerësimi i programit

Asistenca teknike do të përdoret për të mbështetur punën e dy strukturave operuese (SO) kombëtare dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (JMC), duke siguruar një implementim, monitorim dhe vlerësim efikas të programit, si dhe një përdorim optimal të burimeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet ngritjes dhe veprimtarisë së Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) në Shqipëri dhe antenës në Mal të Zi. SPT-ja do të kryejë menaxhimin e përditshëm të programit dhe do të përgjigjet para strukturave operuese dhe Komitetit të Përbashkët të Monitorimit.

Masa II.2: Informimi dhe publiciteti mbi programin

Objekti i kësaj mase është të sigurojë ndërgjegjësim mbi programin në radhët e komuniteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe në përgjithësi ndërmjet popullsisë në zonën e programit. Ai, gjithashtu, do të mbështesë aktivitete ndërgjegjësimi në nivel vendi me qëllim të informojë qytetarët e të dyja vendeve të programit.

Itinerari indikativ dhe shumat për implementimin e masave

Masat I.1, I.2 dhe I.3 do të implementohen nëpërmjet skemave të granteve. Kriteret e detajuara të përzgjedhjes dhe dhënies së granteve do të përshkruhen në paketën e aplikimit të ftesës për propozime (Udhëzuesi për aplikuesit). Është parashikuar që ftesa për propozime, për shumën totale IPA dhe bashkëfinancimi kombëtar prej 1.53 milionë €, do të fillohet në tremujorin e dytë të vitit 2010.

Masat II.1 dhe II.2 konsistojnë në asistencën teknike dhe do të implementohen nëpërmjet marrëveshjeve individuale të granteve të drejtpërdrejta pa ftesë për propozime midis Komisionit Europian dhe autoriteteve kombëtare respektive, në përputhje me nenin 168 1. (c) të rregullave të implementimit të rregullores financiare, duke pasur parasysh se autoritetet kombëtare përkatëse, d.m.th. koordinatorët CBC sipas kuptimit të nenit 22 (2) (b) të rregullores së implementimit IPA dhe strukturat operuese, gëzojnë *de facto* një situatë monopoli për implementimin e programit ndërkufitar. Nënkontraktimi i aktiviteteve të mbuluara nga marrëveshja e drejtpërdrejtë e grantit është e mundur. Marrëveshjet e drejtpërdrejta të granteve, në shumën totale prej 145,300 €, mund të nënshkruhet menjëherë pasi marrëveshja e financimit ka hyrë në fuqi. Shuma e alokuar IPA për masat II.1 dhe II.2 do të plotësohet nga një shumë totale prej 25,641 € të bashkëfinancimit kombëtar që do të sigurohet nga autoritetet e të dyja vendeve.

Ftesat për propozime do të përgatiten me ndihmën e asistencës teknike, të parashikuar në aksin prioritar II të këtij programi. Në veçanti, asistenca teknike do të financojë funksionimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik, i cili do të hartojë Udhëzuesin për Aplikuesit të ftesave për propozime nën mbikëqyrjen e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit.

Një shqetësim potencial mund të jetë mungesa e kapaciteteve absorbuese për gjenerimin e projekteve nga ana e aktorëve lokalë. Ky shqetësim do të adresohet me anë të aktiviteteve nën aksin e asistencës teknike me qëllim shpjegimin e programit përfituesve potencialë.

2.4 Vështrim i shkurtër mbi eksperiencën e kaluar dhe në vazhdim në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë mësimet e nxjerra dhe koordinimin e donatorëve

2.4.1. Eksperienca e kaluar dhe e tashme e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar

Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi është relativisht i vonshëm. Ai është zhvilluar me tepër në nivel të institucioneve qendrore sesa në rajonet kufitare. Bashkëpunimi midis dy vendeve është mbështetur në protokollet dhe marrëveshjet ekzistuese si më poshtë:

- Marrëveshje e tregtisë së lirë midis dy vendeve.
- Protokoli i bashkëpunimit i nënshkruar në dhjetor 2000 midis Ministrisë së Turizmit të Malit të Zi dhe Komitetit Shqiptar për Zhvillimin e Turizmit.
- Forumi rajonal i bashkëpunimit midis Shkodrës dhe Malit të Zi. Përfaqësues të qeverisë lokale dhe sektori privat marrin pjesë në këtë forum.
- Marrëveshja e Lundrimit e nëntorit 2004, sipas së cilës palët kanë rënë dakord me funksionimin e një linje lundrimi ndërkombëtare Shkodër-Virpazar.
- Plani i veprimit strategjik për liqenin e Shkodrës/Skadar e marsit 2007, midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Malit të Zi dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë.

Ky program është, gjithashtu, në harmoni me strategjitë sektoriale të të dyja vendeve: Për Shqipërinë, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Social dhe Ekonomik (NSSED), Strategjia e Decentralizimit, Strategjia e Zhvillimit Rajonal Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGs) 2003 për rajonin e Shkodrës dhe dokumenti Promovimi i Zhvillimit Lokal nëpërmjet MDGs 2003 për rajonin e Kukësit; për Malin e Zi, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Malit të Zi (NSSD), masterplani për zhvillimin e turizmit, plani hapësinor, plani hapësinor i zonës bregdetare.

Për më tepër, programi ndërkufitar në aneksin 2 të këtij vendimi financimi, i cili është hartuar bashkërisht nga autoritetet e Shqipërisë dhe Malit të Zi gjatë gjysmës së parë të vitit 2007, duke ndjekur një proces të gjerë konsultimesh me aktorët në të dyja anët e kufirit, përbën themelin për planifikimet dhe zbatimet shumëvjeçare.

2.4.2. Mësimet e nxjerra

Pjesa më e madhe e iniciativave ndërkufitare ka filluar rishtazi, duke e bërë të parakohshëm përcaktimin e “mësimeve të nxjerra”. Gjithsesi, pikat e mëposhtme mund të theksohen nga eksperiencia ndërkufitare e vendeve të Ballkanit Perëndimor:

- Projektet e fokusuar në mbrojtjen e mjedisit reflektojnë prioritete të përcaktuara nga institucionet kombëtare dhe rajonale, duke u fokusuar në prioritetet lokale të zhvillimit. Gjithsesi, është e rëndësishme të krijohen lidhje të ngushta midis shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin e programit.

- Ftesat për propozime në shuma të vogla për aktivitetet ndërkufitare të bëra në programet e mëparshme ndërkufitare kanë treguar kapacitetet e ulëta për përgatitjen e projekteve nga pjesa më e madhe e përfituesve të fundit. Kjo mund të pengojë implementimin e programit. Trajnimi specifik i aplikantëve potencialë do të jetë thelbësor gjatë gjithë programit.

- Pak bashki kanë pasur rol udhëheqës në iniciativat e kaluara dhe të tashme ndërkufitare. Këto bashki duhet të kenë një rol kryesor në implementimin e programit (transferimi i dijeve etj.).

Për më tepër, një vlerësim i pavarur i programeve të bashkëpunimit ndërkufitar financiar nga programi PHARE u krye nga konsorciumi MWH. Eksperiencia ka treguar se parakushtet për një implementim sa më efektiv përfshijnë, përveç bashkëpunimit të ngushtë midis vendeve pjesëmarrëse në nivelet politike dhe operationale:

- bashkëpunimi ndërkufitar midis ministrive të linjës dhe marrëdhënie efektive të punës midis organizatave të lidhura me to;

- autoritetet lokale dhe të zhvillimit rajonal funksionuese, të pajisura me stafin e duhur në një mjedis të qëndrueshëm;

- marrëdhënie të ngushta pune midis institucioneve dhe delegacioneve respektive të Komisionit;

- bashkëpunim ndërkufitar funksional midis organizatave respektive të sektorit privat, si p.sh., dhomat e tregtisë, shoqatat dhe OJQ-të.

2.4.3. Koordinimi i donatorëve

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i përfshirë në procesin e koordinimit të donatorëve nëpërmjet Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS), një mekanizëm që ka për qëllim të reformojë mënyrën sesi fondet publike (të brendshme dhe të huaja) menaxhohen. IPS-ja u aprovua nga Këshilli i Ministrave në nëntor 2005 me synimin për të qenë një kuadër strategjik koherent, duke siguruar që politikat thelbësore të Shqipërisë dhe proceset financiare, të funksionojnë në një mënyrë koherente, efikase dhe të integruar. Nën programin CARDS 2004, një kontribut i Komisionit European iu siguroi fondit të mirëbesimit të Bankës Botërore për implementimin e IPS-së.

Këshilli i Ministrave pret, gjithashtu, të përmirësojë procesin e konsultimit me komunitetin e donatorëve dhe të harmonizojë ndihmën ndërkombëtare me prioritetet kombëtare nëpërmjet Departamentit të Koordinimit të Strategjive dhe donatorëve në Këshillin e Ministrave. Ministri i Integritit European është emëruar koordinatori kombëtar IPA.

Delegacioni i Komisionit European, në rolin e tij si kryetar i Sekretariatit Teknik të Donatorëve, ka lehtësuar koordinimin e mbledhjes së të dhënave për të gjithë donatorët që nga vitit 2003. Roli i koordinimit të donatorëve është në procesin e të kaluarit gradualisht autoriteteve.

Marrëdhënie të ngushta pune mbahen me institucionet financiare ndërkombëtare (EIB, EBRD, Banka Botërore, KfW).

Në Mal të Zi, koordinimi i donatorëve mbështetet kryesisht nga strategjitë sektoriale, si dhe strategjitë ndërsektoriale mbi reduktimin e varfërisë, zhvillimin e qëndrueshëm etj. Autoritetet malazeze kanë riorganizuar koordinimin e donatorëve dhe kanë emëruar zyrtarë të lartë të qeverisë për të koordinuar ndihmën e donatorëve në të gjithë sektorët kritikë. Agjencia Europiane e Rindërtimit (EAR) në Podgoricë merr pjesë në mënyrë të rregullt në takimet e koordinimit me BE-në dhe donatorë të tjerë bilateralë. Ajo ka zhvilluar, gjithashtu, një marrëdhënie të ngushtë dhe të frytshme me institucionet financiare ndërkombëtare, veçanërisht EIB, EBRD dhe Bankën Botërore; dhe me institucionet financiare bilaterale si KfW gjermane.

Aktivitetet e financuara nga BE-ja, të menaxhuara nga EAR-ja dhe në të ardhmen nga delegacioni i KE-së, kanë kanalizuar investime thelbësore nga këto institucione në fushat e mjedisit dhe infrastrukturës së transportit të Malit të Zi. BE-ja ka zhvilluar, gjithashtu, marrëdhënie të mira pune me agjencitë e OKB-së, në veçanti me UNHCR-në për çështjet e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe me UNICEF-in për çështjet mbrojtjes së fëmijëve. Ajo është duke punuar, gjithashtu, ngushtë me Këshillin e Europës mbi reformën në administratën publike, dhe me OSBE-në në çështjet e drejtësisë, demokracisë dhe sigurisë.

Për sa i përket këtij programi ndërkufitar, vendet anëtare të BE-së dhe institucionet financiare ndërkombëtare janë konsultuar për draftin e programit gjatë procesit të programimit me qëllim identifikimin e komplementaritetëve midis projekteve të ndihmës së donatorëve.

2.5. Çështje horizontale

Aplikimi i përbashkët do të duhet të mbulojë të dyja palët në projekt dhe të përmbushë kriteret e mëposhtme:

- partnerë përfitues nga të dyja anët e kufirit;
- të mbështesë lidhjet midis institucioneve dhe organizatave përkatëse nga të dyja anët e kufirit;
- të inkurajojë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe të grupeve të marginalizuara;
- të plotësojë nevojat e veçanta të minoriteteve etnike;
- të jetë i qëndrueshëm nga ana mjedisore.

Partnerët në projekte duhet të ndërtojnë mekanizma koordinimi të rëna dakord për të sinkronizuar projektet e përbashkëta gjatë gjithë implementimit të tyre.

2.6. Kushtet

- Riorganizimi i strukturës operuese në çdo vend: OS ekzistuese u ngritën me qëllim përgatitjen e programit ndërkufitar. Implementimi i programit mund të kërkojë një tjetër lloj strukture.

- Ngritja e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit.
- Ngritja dhe organizimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT) në Shqipëri dhe antenës në Mal të Zi.

- Emërimi i stafit të duhur për të marrë pjesë në aktivitetet trajnuese, ditët e informimit dhe aktivitetet monitoruese.

2.7. Të dhëna

Këto të dhëna janë të një natyre indikative, në përputhje me seksionin 2.3.

	N	N+1 (kumulative)	N+2 (kumulative)
Numri i granteve të drejtpërdrejta në Shqipëri	0	1	1
Numri i granteve të drejtpërdrejta në Mal të Zi	0	1	1
Numri i ftesave të përbashkëta për propozime të bëra në Shqipëri dhe në Mal të Zi	0	1	1
Norma e kontraktimit (%) në Shqipëri	0	100	100
Norma e kontraktimit (%) në Mal të Zi	0	100	100

* N është data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit.

2.8. Hapat për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontrollet *ex-ante* nga Komisioni

Në përputhje me nenin 8(4)c) të rregullores së implementimit IPA, vendet përfituese duhet të hartojnë një plan me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni.

Në Shqipëri, Këshilli i Ministrave miratoi në shtator 2007 një vendim për ngritjen e strukturave, autoriteteve dhe përcaktimin e përgjegjësive për implementimin e IPAs, sipas Sistemit të Decentralizuar të Implementimit (DIS). Në nëntor 2007, Ministria e Financave i paraqiti Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit një propozim për funksionimin e Njesisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU), e cila dha komentet dhe këshillat e saj në lidhje me këtë propozim. Një projekt asistence teknike nën IPA 2007, ka filluar në janar 2009. Planifikimi indikativ i aktiviteteve të propozuara nga konsulenti i kontraktuar, mund të ndahen në 2 faza: në fazën e parë, me kohëzgjatje një vit, konsulenti do të mbështesë autoritetet shqiptare në rishikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve që kërkohen për të përfunduar me sukses stadi 1 dhe 2 më sipër; gjatë fazës së dytë, me kohëzgjatje 6 muaj, konsulenti do të testojë strukturat e zhvilluara dhe përputhjen e tyre me kërkesat IPA DIS dhe do të zhvillojë trajnime. Me fillimin e projektit, palës shqiptare i është kërkuar të miratojë një plan për sistemin e decentralizuar të implementimit dhe të ngrejë strukturat e zyrtarit të programimit në ministritë e linjës.

Në Mal të Zi puna për shkuarjen drejt decentralizimit pa kontrolle *ex-ante* është në fazat fillestare. Një plan i detajuar dhe tabelë kohore janë përgatitur nga vendi përfitues, në përputhje me udhëzimin e Komisionit “Plani për sistemin e decentralizuar të implementimit” dhe me asistencën e SIGMA-s. Qeveria do të aprovojë një strategji për Sistemin e Decentralizuar të Implementimit. IPA-ja do të mbështesë implementimin e saj dhe është parashikuar që Malit të Zi mund t’i aprovohet Sistemi i Decentralizuar i Implementimit brenda tre vjetëve”.

3. Buxheti për vitin 2009

3.1. Tabela indikative financiare 2009 për Shqipërinë

	Asistenca IPA – BE		Kontributi kombëtar		Totali (IPA plus kontributin kombëtar)	
	EURO	%(1)	EURO	%(1)	EURO	%(2)
Aksi prioritar I	765,000	85	135,000	15	900,000	90
Aksi prioritar II	85,000	85	15,000	15	100,000	10
TOTALI	850,000	85	150,000	15	1,000,000	100%

1. Shprehur në % të totalit (IPA plus kontributin kombëtar) (kolona “c”).

2. Shprehur në % të totalit të madh (“c”). Tregon peshën relative të çdo prioriteti, duke iu referuar fondeve totale (IPA + Kombëtare).

3.2 Tabela indikative financiare 2009 për Malin e Zi

	Asistenca IPA – BE		Kontributi kombëtar		Totali (IPA plus kontributin kombëtar)	
	EURO	%(1)	EURO	%(1)	EURO	%(2)
Aksi prioritar I	540,000	85	95,294	15	635,294	90
Aksi prioritar II	60,000	85	10,588	15	70,588	10
TOTALI	600,000	85	105,882	15	705,882	100%

1. Shprehur në % të totalit (IPA plus kontributin kombëtar) (kolona “c”).

2. Shprehur në % të totalit të madh (c). Tregon peshën relative të çdo prioriteti, duke iu referuar fondeve totale (IPA + kombëtare).

3.3 Parimi i bashkëfinancimit të projekteve të financuara nga programi

Kontributi i Komunitetit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara, në rastin e këtij programi ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi është bazuar në shpenzimet totale, siç është rënë dakord nga vendet pjesëmarrëse dhe parashikuar në programin ndërkufitar.

Norma e kontributit të Komunitetit për këtë program është 85%.
Dispozitat e nenit 90 rregullores së implementimit IPA aplikohen.

4. Plani i implementimit

4.1 Metoda e implementimit

Ky program do të implementohet në mënyrë të centralizuar nga Komisioni European në përputhje me nenin 53a të rregullores financiare¹ dhe dispozitave korresponduese të rregullave të implementimit².

Në rastin e menaxhimit të centralizuar, roli i Komisionit në përzgjedhjen e projekteve në kuadër të këtij programi ndërkufitar midis vendeve përfituese specifikohet në nenin 140 të rregullorja e implementimit IPA.

4.2 Rregullat e përgjithshme për procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit

Prokurimi duhet të zbatohet sipas dispozitave të pjesës II, titulli IV të rregullores financiare dhe pjesës II, titulli III, kapitulli 3 i rregullave të implementimit, si dhe rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjet dhe punimet, të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane për qëllime bashkëpunimi me vendet e treta adoptuar nga Komisioni në datë 24 maj 2007 (C(2007)2034).

Procedurat e dhënies së grantit duhet të ndjekin dispozitat e pjesës I, titulli VI të rregullores financiare dhe pjesës I, titulli VI të rregullave të tij të implementimit.

Sipas rastit, autoriteti kontraktues do të përdorë, gjithashtu, formatin standard dhe modelet që lehtësojnë aplikimin e rregullave të mësipërme, të cilat ndodhen në “Udhëzuesin praktik të procedurave të kontraktimit për veprimet e huaja të KE-së” (Udhëzuesi praktik) publikuar në faqen e internetit të EuropeAid³ në datën e fillimit të procedurave të prokurimit ose dhënies së granteve.

4.3 Vlerësimi i ndikimit mjedisor (EIA) dhe ruajtja e natyrës (sipas rastit)

Te gjitha investimet duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin komunitar mjedisor.

Procedurat për vlerësimin e ndikimit mjedisor parashikuar në direktivën⁴ EIA aplikohen plotësisht në të gjitha projektet e investimeve nën instrumentin IPA. Nëse direktiva EIA nuk është transpozuar plotësisht, procedurat duhet të jenë të ngjashme me ato të vendosura në këtë direktivë.

Nëse një projekt ka të ngjarë të ketë ndikim në vendet me rëndësi për ruajtjen e natyrës, një vlerësim i saktë i ruajtjes së natyrës duhet të bëhet, ekuivalente me atë të nenit 6 të direktivës së habitatit dhe duhet të dokumentohet⁵.

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1 Monitorimi

Implementimi i programit ndërkufitar do të monitorohet nga komiteti i përbashkët i monitorimit sipas nenit 142 të rregullores së implementimit IPA, ngritur nga vendet përfituese pjesëmarrëse, i cili përfshin edhe përfaqësues të Komisionit.

Në Shqipëri, Komisioni mund të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron si të nevojshëm për të monitoruar programin në fjalë.

5.2 Vlerësimi

Programi do të jetë subjekt i vlerësimeve në përputhje me nenin 141 të rregullores së implementimit IPA, me qëllimin për të përmirësuar cilësinë, efektivitetin dhe konsistencën e ndihmës së Komunitetit, strategjinë dhe implementimin e programit ndërkufitar.

¹ Rregullorja 1605/2002 (OJ L 248, 16.9.2002, faqe 1) si amenduar nga rregullorja (EC, Euratom) nr.1995/2006 (OJ L 390, 30.12.2006, faqe 1).

² Rregullorja 2342/2002 (OJ L 357, 31.12.2002, faqe 1) si amenduar nga rregullorja (EC, Euratom) nr.478/2007 (OJ L 111, 28.4.2007, faqe 13).

³ Adresa: http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical_guide/index_en.htm.

⁴ Direktiva e Këshillit 85/337/EEC e datës 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (OJ L 175, 5.7.1985, faqe 40). Direktivë e amenduar se fundmi nga direktiva 2003/35/EC, OJ L 156, 25.6.2003, faqe 17.

⁵ Direktiva e Këshillit 92/43/EEC e datës 21 maj 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe fauna dhe florës së egër (OJ L206, 22.7.1992). Direktivë e amenduar se fundmi nga rregullorja (EC) nr. 1882/2003 (OJ L284, 31.10.2003, faqe 1)

6. Auditimi, kontrolli financiar dhe masat antimashttrim

Llogaritë dhe aktivitetet e të gjitha palëve, të përfshira në implementimin e këtij programi, si dhe të gjitha kontratat dhe marrëveshjet që implementojnë këtë program, janë subjekt, nga njëra anë, i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të Komisionit (duke përfshirë edhe Zyrën Europiane të Antimashttrimit), të cilat mund të zhvillojnë kontrole, kur e gjykon të arsyeshme, ose vetë ose nëpërmjet një audituesi të jashtëm, nga ana tjetër, audituesve nga Gjykata Europiane e Llogarive. Kjo përfshin masa të tilla, si p.sh., verifikimin *ex-ante* të tenderimit dhe kontraktimit të zhvilluara nga delegacionet e vendeve përfituese.

Me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje efikase të interesave financiare të Komunitetit, Komisioni (duke përfshirë edhe Zyrën Europiane të Antimashttrimit) mund të zhvillojnë kontrole në vend dhe inspektive në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96¹.

Kontrollet dhe auditimet e përshkruara më lart aplikohen për të gjithë kontraktuesit, nënkontraktuesit dhe përfituesit e grantit që kanë përfituar fonde nga Komuniteti.

7. Ndryshimet e kufizuara

Ndryshime të limituara në implementimin e këtij programi që kanë ndikim mbi elementet thelbësore të listuar në nenin 90 të rregullave të implementimit të rregullores financiare, e cila është e një natyre indikative², mund të ndërmerren nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të delegimit (AOD), ose nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të nëndelegimit (AOSD), në përputhje me pushtetin e deleguar nga ana e AOD, në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë financiar pa qenë i nevojshëm një vendim ndryshimi financiar.

LIGJ

Nr.10 334, datë 14.10.2010

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE “PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI - ISH- REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË, PËR VITIN 2009, TË KOMPONENTIT TË DYTË TË INSTRUMENTIT TË NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA) - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR PËR SHQIPËRINË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane “Për programin ndërkufitar Shqipëri – ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, për vitin 2009, të komponentit të dytë të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA) - Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6740, datë 21.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

¹ Rregullorja e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96 e datës 11 nëntor 1996, OJ L 292; 15.11.1996; faqe 2.

² Këto elemente thelbësore janë të natyrës indikative, shuma indikative e ftesës për propozime dhe, për prokurimet, numri indikativ, lloji i kontratave i parashikuar dhe itinerari indikativ për fillimin e procedurave të prokurimit.

MARRËVESHJE FINANCIMI

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN NDËRKUFITAR NDËRMJET ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË DHE SHQIPËRISË NËN INSTRUMENTIN E ASISTENCËS SË PARAADERIMIT (IPA) KOMPONENTI II - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR PËR VITIN 2009 (Menaxhimi i centralizuar)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si "Palët" ose individualisht si "Vendi përfitues" në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose "Komisioni", në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

duke pasur parasysh se:

a) Më 1 gusht 2006, Këshilli i Bashkimit Europian vendosi me anë të rregullores (EC) nr. 1085/2006 krijimin e një instrumenti të asistencës së paraaderimit (këtej e tutje "Rregullorja kuadër IPA"). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet candidate (së fundmi Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe candidate potenciale (Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Mali Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën sipas rezolutës së Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244) në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t'u bërë një ditë anëtare të Bashkimit Europian.

b) Më 12 qershor 2007 Komisioni vendosi me anë të rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje "Rregullorja e zbatimit IPA").

c) Asistenca komunitare nën instrumentin e asistencës së paraaderimit duhet të vazhdojë t'i mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë.

Për vendet potenciale candidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural;

d) Palët kanë nënshkruar më 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën Instrumentin e Paraaderimit.

e) "Programi ndërkufitar ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Shqipëri" për periudhën 2007-2009 u aprovua në datë 10 dhjetor 2007 me anë të vendimit C (2007)5995.

f) Komisioni aprovoi në datë 2 shtator 2009 propozimin financiar për vitin 2009 të "Programit ndërkufitar ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Shqipëri" (këtej e tutje "Programi"). Ky program do të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar.

g) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. PROGRAMI

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: 2009/021-584 (pjesa e Shqipërisë) dhe 2009/021-138 (pjesa e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë) (CRIS).

Titulli: Programi ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA për vitin 2009.

2. ZBATIMI I PROGRAMIT

1. Programi do të zbatohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të komuniteteve, të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të 13 dhjetorit 2006 (këtej e tutje "Rregullorja financiare").

2. Programi do të zbatohet në përputhje me rregullat e marrëveshjes financiare në rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet palëve më 18 tetor 2007 (këtej e tutje "Marrëveshja kuadër"), e cila është përcaktuar në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. STRUKTURAT DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA, në përputhje me marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfituesit përballë Komisionit. Ai duhet të sigurojë se ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së të paraaderimit nën instrumentin IPA.

2. Koordinator kombëtar IPA do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet që përfshijnë vende që lagen nga dete, nën instrumente të tjera të Komunitetit.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese për pjesën e programit në territorin e vet. Funksionet dhe përgjegjësitë e saj janë përcaktuar në programin ndërkufitar, me përjashtim të tenderimit, kontraktimit, dhe pagesave, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. Struktura operuese duhet të bashkëpunojë ngushtë gjatë implementimit të këtij programi me strukturën operuese të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

5. Sipas nenit 142 të rregullores së zbatimit IPA, strukturat operuese të vendeve pjesëmarrëse duhet të ngrenë një Sekretariat të Përbashkët Teknik për të asistuar strukturat operuese dhe Komitetin e Përbashkët Monitorues në përmbushjen e detyrave të tyre respektive.

Sekretariati i Përbashkët Teknik mund të ketë antenë të ngritura në secilin vend pjesëmarrës.

4. FINANCIMI

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2009 është përcaktuar në një maksimum prej €850 000, për pjesën e programit për Shqipërinë, siç detajohet në shtojcën A1 të aneksit A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Kostoja e strukturave dhe autoriteteve të ngritura nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi do të mbulohen nga Përfituesi, me përjashtim të kostove referuar në nenin 94(1)(f) të rregullores së zbatimit IPA, siç detajohet në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

5. AFATI PËRFUNDIMTAR PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale të cilat zbatojnë këtë Marrëveshje do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. AFATI PËR EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda 2 vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i zbatimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. AFATI I DISBURSIMIT

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data përfundimtare e ekzekutimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të saj.

8. TRAJTIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat, në kuadër të IPA-së përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose të ardhura të tjera ekuivalente me përjashtim:

a) të të ardhurave të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimeve në firma;

b) të të ardhurave të nxjerra brenda kuadrit të një mase inxhinierie financiare, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributet nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Të ardhurat, siç përkufizohen në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme përkatëse për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionale, në varësi të asaj nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. SHPENZIMET E LEJUESHME

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH);

b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;

c) blerjet, dhëniet me qira ose me kredi të trullit dhe godinave ekzistuese;

d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;

e) kostot operacionale;

f) pajisje të dorës së dytë;

g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;

h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;

i) kontribute në natyrë;

j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

a) Taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre,

ii) është përcaktuar që ato janë kryer nga përfituesi përfundimtar, dhe

iii) janë të identifikuara qartë në projektpropozim.

b) Detyrimet për transaksione financiare transnacionale;

c) Në rast se zbatimi i një aktiviteti kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;

d) Kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë ose, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me aktivitetin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;

e) Kostot e garancisë të siguruara nga një bankë ose institucione të tjera financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit;

f) Shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë, të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare, nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkte të një aktiviteti i cili mund të ndikojë nivelin e

shpenzimeve të përgjithshme. Përlllogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht;

g) Blerja e trullit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit respektiv.

4. Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritetet publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:

a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi final gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti;

b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi final që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë, nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht ose direkt për aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'ua ngarkojnë kostot e referuara në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesve përfundimtarë ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.

Kostot e referuara në pikën "b" të këtij paragrafi duhet të jenë të certifikuara me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë aktivitet.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programin ndërkufitar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

10. RUAJTJA E DOKUMENTEVE

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Europian mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. PLANI PËR DECENTRALIZIMIN PA KONTROLLE *EX-ANTE*

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan indikativ për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1, dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipat e ndryshëm të kontrolleve *ex-ante*.

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. INTERPRETIMI

1. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të ruajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, referencat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë referencat e kësaj Marrëveshjeje, të ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të zhvendosen në këtë Marrëveshjeje me anë të amendimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë interpretimin e saj.

13. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME DHE BOSHLLËQET E PAQËLLIMSHME

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshje përmban boshllëqe të paqëllimshme, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të mbushin çdo boshllëk të paqëllimshëm nëpërmjet një dispozite, e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë të rëna dakord ndërmjet palëve.

2. Çdo ndryshim për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshime të tilla do të hyjnë në fuqi, pasi vendosen ndërmjet palëve.

15. PËRFUNDIMI

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshjeje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare, në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshjeje mund të përfundojë nga secila palë duke informuar me shkrim palën tjetër. Ky përfundim do të ketë efekt gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Mosmarrëveshjet e dala nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen miqësisht nëpërmjet konsultimit mes palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila palë mund ta çojë çështjen për gjykim në përputhje me rregullat fakultative të gjykimit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit Gjykimet që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë gjuha angleze. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkesë me shkrim të dërguar nga cilado nga palët. Vendimi i gjykatësit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelues.

17. NJOFTIME

1. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshjeje do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshjeje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:
z. Helmuth Lohan
Shef i delegacionit të KE-së
Qendra e biznesit "ABA"
Rruga: "Papa Gjon Pali II", K.17
Tiranë, Shqipëri
Fax: + 355 4 2230 752

Për vendin përfitues
znj. Majlinda Bregu
Ministre e Integritimit
Rruga: "Papa Gjon Pali II", nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Fax +355 4 2256267

18. GJUHA

Marrëveshja e financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. SHTOJCAT

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga pala e dytë.

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë, më datë.....

nga

znj. Majlinda Bregu

Ministre e Integritimit European

Firmosur, për dhe në emër të Komisionit, në Tiranë, më datë

nga

z. Helmuth Lohan

Shef i Delegacionit

ANEKSI A

PROGRAMI NDËRKUFITAR NDËRMJET ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË
MAQEDONISË DHE SHQIPËRISË NËN KOMPONENTIN IPA BASHKËPUNIMI
NDËRKUFITAR PËR VITIN 2009

SHTOJCA A1

PROPOZIMI FINANCIAR PËR VITIN 2009 TË PROGRAMIT NDËRKUFITAR NDËRMJET
ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË DHE SHQIPËRISË, APROVUAR ME
VENDIMIN E KOMISIONIT C (2009) 6638 TË DATËS 2 SHTATOR 2009

SHTOJCA A2

PROGRAMI NDËRKUFITAR 2007-2009 IPA CBC ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E
MAQEDONISË – SHQIPËRI, APROVUAR ME VENDIMIN E KOMISIONIT C (2007) 5995
TË DATËS 10 DHJETOR 2007

ANEKSI B

MARRËVESHJA KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DATË 18 TETOR
2007

ANEKSI C

RAPORTIMI

1. Strukturat operuese të vendeve përfituese në një program ndërkufitar duhet t'i dërgojnë Komisionit dhe koordinatorëve kombëtarë respektivë IPA një raport vjetor dhe një raport përfundimtar mbi zbatimin e programit ndërkufitar pas kontrollit të tyre nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason adaptimin e programit ndërkufitar.

Raporti përfundimtar duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) Progresin e bërë gjatë zbatimit të programit ndërkufitar dhe prioritetet në raport me qëllimet specifike, të verifikueshme, me një përcaktim sasior të sasisë, kurdo dhe kudo që kjo të jetë e mundur, duke përdorur indikatorët në nenin 94 (1) “d” të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akteve prioritare.

b) Hapat e ndërmarrë nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave,
- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo mase të marrë;
- përdorimin e asistencës teknike.

c) Masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat “a” deri në “c” të këtij paragrafi mund të jepet në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën “b” të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

VENDIMI I KOMISIONIT
C(2009)6638 I DATËS 2 SHTATOR 2009
PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR ISH-REPUBLIKA
JUGOSLLAVE E MAQEDONISË-SHQIPËRI NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT
NDËRKUFITAR TË INSTRUMENTIT TË PARAADERIMIT

Komisioni i Komuniteteve Europiane,
duke pasur parasysh traktatin themelues të Komunitetit Europian,
duke pasur parasysh rregulloren e Këshillit (KE) nr.1085/2006 të datës 17 korrik 2006 që vendos Instrumentin për Asistencën e Paraaderimit (IPA)¹ dhe veçanërisht nenin 14 (2) (a),
Meqë:

1. Rregullorja (KE) nr.1085/2006 përcakton objektivat dhe parimet kryesore për asistencën e paraaderimit për vendet candidate dhe kandidatë potencialë.

2. Në përputhje me nenin 7 të rregullores së Komisionit (KE) nr.1085/2006, asistenca duhet të sigurohet mes programeve vjetore ose shumëvjeçare, që mund të vendoset nga vendi, nga një grup vendesh ose nga komponenti. Këto programe duhet të përpilohen në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të politikave referuar në nenin 4 të rregullores së Këshillit nr.1085/2006, dhe dokumentet përkatëse të planifikimit indikativ shumëvjeçar referuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli ka vendosur një partneritet aderimi për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë² dhe një partneritet europian për Shqipërinë³. Më 4 shtator 2008, Komisioni miratoi Dokumentin e Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar 2008-2010 për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në 29 shtator 2008, Dokumentin e Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar 2008-2010 për Shqipërinë, të cilat përmbajnë prioritetet kryesorë të asistencës së paraaderimit për këto vende⁴.

4. Në përputhje me nenin 91 të rregullores së Komisionit (KE) nr.718/2007 të datës 12 qershor 2007 në zbatim të rregullores së Këshillit (KE) nr.1085/2006 që vendos Instrumentin për Asistencën e Paraaderimit (IPA)⁵ (këtej e tutje referuar si rregullorja e zbatimit IPA), Komisioni miratoi në 10 dhjetor 2007 programin shumëvjeçar të bashkëpunimit ndërkufitar ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Shqipëri 2007-2009 (vendimi C(2007)5995).

5. “Programi shumëvjeçar ndërkufitar ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Shqipëri” ka si synim sigurimin e asistencës për të nxitur një zhvillim lokal të qëndrueshëm në zonat ndërkufitare mes tre objektivave specifike të përcaktuar si mbrojtja dhe valorizimi i burimeve natyrore, nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe zhvillimi i partneriteteve afatgjata dhe rrjeteve në rajon. Këta objektiva do të arrihen mes zbatimit të dy prioritetëve, i pari për zhvillimin ekonomik, social dhe ambiental ndërkufitar, dhe i dyti do të sigurojë asistencë teknike për zbatimin e programit.

¹ OJ L 210, 31.7.2006, faqe 82.

² Vendim i Këshillit 2008/212/KE i datës 18 shkurt 2008 (OJ L 80, 19.3.2008, faqe 32).

³ Vendim i Këshillit 2008/210/KE i datës 18 shkurt 2008 (OJ L 80, 19.3.2008, faqe 1-17).

⁴ Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: C (2008) 4705; për Shqipërinë C (2008) 5352.

⁵ OJ L 170, 29.6.2007, faqe 1.

6. Ky program ndërkufitar mes ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë u zbatua për vitin 2007 me vendimin e financimit C(2007) 5995 i datës 10 dhjetor 2007 dhe për vitin 2008 nga vendimi i financimit C(2008)4190 i datës 7 gusht 2008. Një vendim i ri financimi duhet të miratohet për të mbuluar zbatimin për vitin 2009.

7. Për vitin 2009, ky vendim është në përputhje me kërkesat e nenit 90 të rregullores së Komisionit (KE, Euroatom) nr.2342/2002 i datës 23 dhjetor 2002, që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e rregullores së Këshillit nr.1605/2002¹ dhe krijon kështu një vendim financimi brenda parashikimit të nenit 75 (2) të rregullores së Këshillit (KE, Euroatom) nr.1605/2002 të datës 25 qershor 2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme mbi buxhetin e Komuniteteve Europiane².

8. Masat e parashikuara nga ky vendim janë në përputhje me opinionin e Komitetit të IPA-së,

ka vendosur si më poshtë:

Neni 1

Miratohet propozimi financiar për vitin 2009 për programin ndërkufitar ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Shqipëri, siç parashikohet në aneksin e këtij vendimi. Programi do të zbatohet në mënyrë të centralizuar.

Programi që i korrespondon vitit buxhetor 2009 do të zbatohet nëpërmjet një marrëveshjeje financimi që do të lidhet mes Komisionit dhe qeverive të çdo vendi pjesëmarrës, në përputhje me marrëveshjen kuadër, të lidhur mes të njëjtave palë në janar 2008 për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe më 18 tetor 2007 për Shqipërinë. Secila nga këto marrëveshje financimi do të mbulojë kontributin e Komunitetit për vendin përfitues dhe vitin përkatës.

Neni 2

Vlera maksimale e kontributit të Komunitetit do të jetë 1.0 milion euro për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe 850 000 euro për Shqipërinë, të financuara nga zëri 22.020402 i buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane për vitin 2009.

Nënshkruar në Bruksel,

PËR KOMISIONIN
(...)
Anëtar i Komisionit

¹ OJ L 357, 31.12.2002, faqe 1.

² OJ L 248, 16.9.2002, faqe 1.

SHTOJCA A1

PROPOZIMI FINANCIAR PËR VITIN 2009 PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR: ISH - REPUBLICA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË-SHQIPËRI

1. IDENTIFIKIMI

Përfituesit	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Shqipëria
Numri CRIS	2009/021-138; 2009/021-584
Viti	2009
Kostoja	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë: €1.0 milionë Shqipëria: €850 000 Vlera totale e kontributit IPA: €1.85 milionë
Strukturat operuese	Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Ministria e Vetëqeverisjes Vendore Në Shqipëri: Ministria e Integritimit European
Autoritetet zbatuese	Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Komisioni European Për Shqipërinë: Komisioni European
Data përfundimtare për hyrjen në fuqi të marrëveshjes së financimit	Jo më vonë se 31 dhjetor 2010
Datat përfundimtare për nënshkrimin e kontratave	2 vjet pas datës së miratimit të marrëveshjes së financimit. Nuk ka afat për projektet e auditimit dhe vlerësimit që mbulohen nga kjo marrëveshje financimi, duke iu referuar nenit 166(2) të rregullores financiare. Këto data vlejné edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Data përfundimtare për zbatimin e marrëveshjes	2 vjet nga data përfundimtare e nënshkrimit të kontratave. Këto data vlejné edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Kodi sektorial	41010, 33210, 15150, 16010
Zërat buxhetorë përkatës	22.020401
Menaxheri përgjegjës i programit	Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: sektori ELARG.B2 Për Shqipërinë: sektori ELARG.C4
Menaxheri përgjegjës i zbatimit	Për Shqipërinë: Delegacioni i Komisionit European në Tiranë Për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Delegacioni i Komisionit European në Shkup

2. PËRMBLEDHJE

2.1. HYRJE

2.1.1. Lidhja me MIPD

Referencë strategjike e programit është Dokumenti i Planifikimit Indikativ Shumëvjeçar (DPISH-MIPD) 2008-2010. Ashtu siç thekson DPISH i ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, duke pasur parasysh statusin kandidat të vendit, bashkëpunimi ndërkufitar ka për qëllim ndër të tjera familjarizimin e vendeve anëtare të ardhshme me rregullat dhe procedurat që udhëheqin qëllimin bashkëpunimin territorial european në kuadër të fondeve strukturore. Ai para së gjithash përqendrohet në krijimin e lidhjeve midis rajoneve kufitare, duke mbështetur mbrojtjen e përbashkët të ambientit dhe përmirësimin e potencialeve të turizmit. Këto janë prioritetet dhe objektivat kryesore, të cilat kanë udhëhequr përgatitjen e bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor.

2.1.2 Procesi i programimit

Procesi i programimit u zhvillua në periudhën dhjetor 2006 dhe maj 2007 dhe u mbështet në të dy vendet nga projekti “Ndërtimi institucional ndërkufitar” (Cross-border Institution Building-CBIB). Në secilin vend ai u koordinua nga koordinatorët respektivë për bashkëpunimin ndërkufitar (Ministria e Vetëqeverisjes Lokale në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Ministria e Integritit European në Shqipëri).

Në dhjetor 2006/janar 2007 secili vend ngriti një grup operacional (OT) që kishte për detyrë përgatitjen e programit ndërkufitar. Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ky grup përbëhej nga 11 përfaqësues (ministritë sektoriale, agjencitë shtetërore dhe përfaqësues të përfituesve finalë) dhe në Shqipëri ky grup përbëhej nga 6 anëtarë. Komiteti i Përbashkët i Programimit, i ngritur në janar 2007 përbëhej nga anëtarë të grupeve operationale.

Hapat e ndryshëm të programit ndërkufitar (situata dhe analiza SWOT, objektivat dhe strategjia, rregullat e zbatimit) iu prezantuan grupeve operationale dhe u komentuan gjatë takimeve të organizuara pothuajse çdo muaj në secilin vend. Këto takime u ndoqën, gjithashtu, nga përfaqësues të Komisionit European (EAR, DKE). Gjatë kësaj periudhe Komiteti i Përbashkët i Programimit u takua dy herë, një herë në Ohër më 12 prill (miratimi i rajonit përfitues dhe prezantimi i situatës dhe analizës SWOT) dhe një herë në Korçë më 23 maj (miratimi i draftit përfundimtar të dokumentit).

2.1.3 Lista e zonave përfituese

Zona përfituese në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë përfshin tri rajone statistikore që i korrespondojnë klasifikimit NUTS III: Pelagonia, Jugperëndimi dhe Polog.

Zona përfituese në Shqipëri përfshin tri rajone administrative që i korrespondojnë klasifikimit NUTS III: qarqet Dibër, Elbasan dhe Korçë.

Territori i zonave të lejuara është pothuajse i njëjtë në secilin vend dhe popullsia është e mirëbalancuar. Megjithatë, analiza e rajonit ndërkufitar zbuloi diferenca të mëdha ndërmjet dy vendeve dhe madje më të mëdha ndërmjet pjesës jugore dhe veriore të rajonit, tiparet demografike dhe tendencat ekonomike janë të ndryshme dhe ndonjëherë kontradiktore. Këto mospërputhje u morën parasysh gjatë përcaktimit të strategjisë së programit.

2.2 Objektivi (at) i përgjithshëm i programit

Objektivi i përgjithshëm i programit është “Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në zonën ndërkufitare”. Aksionet dhe projektet ndërkufitare të përbashkëta të zbatuara në kuadër të programit duhet të kenë një ndikim në situatën socio-ekonomike të popullatës, të përmirësojnë menaxhimin e përbashkët dhe vlerësimin e burimeve njerëzore, natyrore dhe kulturore dhe të forcojnë imazhin dhe kohezionin e rajoneve dhe nënrajoneve ndërkufitare.

Janë përcaktuar tre objektiva specifike:

2.2.1. Objektivi specifik 1

Të mbështesë kryerjen e aksioneve dhe strategjive të përbashkëta që kanë për qëllim mbrojtjen dhe vlerësimin e burimeve natyrore të rajonit.

2.2.2. Objektivi specifik 2

Të forcojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të rajonit.

2.2.3. Objektivi specifik 3

Është një objektivi i tërthortë: të zhvillojë partneritete afatgjata dhe rrjete ndërmjet organizatave të shoqërisë civile (OJF, organizatave sportive etj.), organizatave të specializuara (dhoma tregtie, organizata të sipërmarrësve dhe fermerëve) dhe institucione të decentralizuara, në veçanti shkolla dhe fakultete, duke përfshirë njësitë e kërkimit dhe të zhvillimit.

2.3 Akset prioritare, masat e tyre dhe aspektet e tyre specifike në lidhje me zbatimin e buxhetit 2009

2.3.1. Prioriteti 1: Forcimi i zhvillimit ndërkufitar ekonomik, mjedisor dhe social .

Ky prioritet është një përgjigje ndaj situatave të ndryshme dhe ndonjëherë kontrastuese dhe ndaj nevojave për t'u identifikuar brenda rajonit ndërkufitar. Mbrojtja dhe menaxhimi i burimeve natyrore janë konsideruar si çështje ndërkufitare në pjesën jugore (liqenet e Ohrit dhe Prespës), ndërsa çështjet sociale të lidhura me varfërinë dhe papunësinë janë konsideruar si një prioritet parësor në veri. Prioriteti i parë përpiqet të bashkojë këto dy drejtime. Ai gjithashtu përpiqet t'i lërë

hapësirë aktoreve ekonomike në veçanti në sektorin e turizmit, por jo vetëm, i cili merr parasysh nivelin e ulët të bashkëpunimit të biznesit në kufi. Në mënyrë më të përgjithshme, ky prioritet duhet të lejojë përcaktimin dhe zbatimin e aksioneve “njerëzit për njerëzit” dhe kështu të forcojë bashkëpunimin ndërkuftar në nivelet e komunitetit dhe të shoqërisë civile.

- Masa 1: Zhvillimi ekonomik me theks në zonat e lidhura me turizmin

Turizmi është një nga potencialet kryesore ekonomike të rajonit dhe në disa zona ai është tashmë i zhvilluar, pothuajse si një industri. Kjo masë ka për qëllim të mbështesë zhvillimin e infrastrukturave të vogla, praktikave më të mira dhe planet strategjike, me qëllim që të zgjerojë aktivitetet turistike në të gjithë zonën ndërkuftare. Vëmendje e veçantë i është dhënë transferimit të njohurive nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë në Shqipëri, ku turizmi është ende në fazë fillestare. Kjo masë u jep prioritet llojeve alternative të turizmit (turizmit rural dhe familjar, ekoturizmit etj.) që ato të mund të zhvillohen paralelisht në praktika më klasike. Në përgjithësi kjo masë ka për qëllim forcimin e të gjithë sektorëve të ekonomisë që kontribuojnë për ndërtimin e një identiteti të fortë dhe të veçantë në rajonin ndërkuftar. Kjo përfshin promovimin dhe mbrojtjen (markimin, hyrje më të mirë në treg) e ushqimit tradicional dhe produkteve bujqësore, si dhe të punimeve artizanale. Si një objektiv i tërthortë dhe me qëllimin që t'i ofrojë komunitetit të biznesit mundësinë për të marrë pjesë në programin ndërkuftar, kjo masë synon gjithashtu lehtësimin e bashkëpunimit të biznesit transkuftar (si p.sh., organizimin e panairove, studimeve për konsumatorët etj.).

- Masa 2: Zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor me një theks në mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe ekosistemeve

Kjo masë ka për qëllim të zhvillojë më tej dinamikën ndërkuftare të filluar në sektorin mjedisor gjatë viteve të fundit. Ajo do të mbështesë përpjekjet e deritanishme të autoriteteve lokale dhe kombëtare për hartimin e politikave mjedisore të përbashkëta dhe programeve pilot dhe do të përfshijë në proces dhe shoqërinë civile. Ajo do të marrë në konsideratë rëndësinë themelore të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore për zhvillimin ekonomik të rajonit.

- Masa 3: Kohezion social dhe shkëmbim kulturor ndërmjet aksioneve “Njerëzit për njerëzit” dhe “Institucionet për institucionet”

Duke u bazuar në faktin që bashkëpunimi ndërkuftar është ende në nivel të ulët, masa e tretë ka për qëllim specifik të promovojë aktivitetet “njerëzit për njerëzit” dhe “Institucionet për institucionet” (si p.sh. shkolla, universitete, qendra kërkimore). Sektorët prioritarë janë vlerësimi i trashëgimisë unike historike dhe kulturore dhe të gjitha llojet e aktiviteteve që mbështesin integrimin social të grupeve të marginalizuara, të papunët, rininë rurale, forcën e punës të përfaqësuar nga gratë etj. Kjo masë ka gjithashtu për qëllim të inkurajojë aktivitete të përbashkëta kërkimore dhe edukative.

Të gjitha aktivitetet të lidhura me prioritetin 1 do të zbatohen me anë të granteve. Kriteret e detajuara të përzgjedhjes dhe të dhënies së granteve, siç parashikohen në udhëzuesin praktik (PRAG) për procedurat e kontraktimeve për asistencën e jashtme të KE. Kriteret e detajuara të seleksionimit dhe dhënies së granteve do të përcaktohen në ftesën për projektpropozime-paketën e aplikimit (udhëzime për aplikuesit).

Për buxhetin e vitit 2009, pritet të shpallet një ftesë për projektpropozime gjatë gjashtëmuajt të dytë të vitit 2010, e cila mund të mbulojë të tri masat dhe mund të përfshijë grante “të vogla” dhe “të mëdha” (maksimumi 200 000 euro).

2.3.2. Prioriteti 2: Asistenca teknike

Fondet për asistencë teknike (AT) (10 % të kontributit të Komunitetit) do të përdoren për të mbështetur aktivitete të strukturës operationale dhe të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit. Fondet AT mund të përdoren për të mbuluar kostot për menaxhimin dhe implementimin e programit në secilin vend pjesëmarrës. Këto mund të përfshijnë, ndër të tjera, kostot e mëposhtme:

- Mbështetje për strukturat operuese dhe për Komitetin e Përbashkët të Monitorimit;
- Ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe antenës së tij, duke përfshirë kostot për stafin, me përjashtim të pagave për nëpunësit nga sektori publik;
- Shpenzimet për pjesëmarrjen në takime të ndryshme që lidhen në zbatimin e programit;

- Kosto administrative dhe operacionale, duke përfshirë kostot për përgatitjen, monitorimin dhe vlerësimin e programeve, zgjedhjen e projekteve, organizimin e takimeve që lidhen me programin, kostot për përkthimin, informimin dhe publicitetin.

Referuar nenit 90(2) të rregullores (EC) nr. 718/2007 (rregullorja e zbatimit IPA) prioriteti asistencë teknike, ashtu si dhe çdo prioritet tjetër i programeve ndërkufitare, kërkon 15% bashkëfinancim nga fondet kombëtare.

Duke pasur parasysh faktin se dy autoritetet kombëtare strukturat operuese për bashkëpunimin ndërkufitar kanë në dorë *de facto* një situatë monopoliste (sipas nenit 168, paragrafi 1, nënparagrafi c i rregullores së zbatimit të rregullores financiare) për implementimin e programit ndërkufitar, ndërmjet Komisionit (delegacioneve të Komisionit Europian) dhe autoriteteve kombëtare respektive, do të bëhen marrëveshje direkte granti individuale pa ftesë për projektpropozime për shumën siguruar nga prioriteti AT.

Në përputhje me nenin 120 (1) të rregullores financiare dhe nenit 184 (1) të rregullores së zbatimit të rregullores financiare, është i mundur nënkontraktimi i aktiviteteve mbuluar nga marrëveshja direkte e grantit (p.sh. vlerësimi i AT, publiciteti etj.).

Marrëveshjet direkte të grantit mund të firmosen sapo marrëveshjet financiare janë nënshkruar (2010).

2.4. Vështrim mbi eksperiencën e tanishme dhe të kaluar ndërkufitare, duke përfshirë mësimet e nxjerra dhe koordinimin e donatorëve

Deri tani, iniciativat ndërkufitare në zonën përfituese kanë prekur kryesisht çështjet mjedisore dhe janë përqendruar në zonën jugore. Megjithëse rajoni tashmë ka një rol udhëheqës në ngritjen e një menaxhimi të përbashkët ndërkufitar të burimeve natyrore, bashkëpunimi ndërkufitar është ende në një nivel të ulët.

Dinamika e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë ka nisur në 1997-1999, nëpërmjet programit shumëvëndësh CREDO në kuadër të PHARE, i cili kishte për qëllim promovimin e marrëdhënies së mirë të fqinjësisë, stabilitetit social dhe zhvillimit ekonomik në zonën kufitare. Programi siguroi fonde për implementimin e projekteve ndërkufitare në fushat e mjedisit, bashkëpunimit të OJF-ve dhe administratës lokale.

Projekti për mbrojtjen e liqenit të Prespës është konsideruar shpesh si një model i integritetit të menaxhuar të burimeve ujore ndërkufitare. Në vitin 2004 qeveritë e të dy vendeve nënshkruan një marrëveshje për “Mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe ujëndarësve të tij”. Ekzistenca e strukturave të përbashkëta, si dhe e një marrëveshjeje bilaterale sigurojnë një kuadër të mirë për iniciativa të mëtejshme ndërkufitare.

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) mbështet iniciativa ndërkufitare ndërmjet Dibrës në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Peshkopisë në Shqipëri. Projekti trajnon vendimmarrësit lokalë dhe ekspertët përkatës për të identifikuar dhe përgatitur projekte investimesh në fushën e ambientit dhe për të paraqitur aplikime financiare profesionale. Probleme prioritare lidhur me sigurimin e ujit dhe mbledhjen dhe derdhjen e ujërave të zeza.

Organizata Ndërkufitare për Bashkëpunim e Zhvillimit (ICCO-Holandë) mbështet bashkëpunimin ndërkufitar rajonal dhe rrjetin e shoqërisë civile në pjesën veriore të rajonit ndërkufitar. Ky program ka për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërkufitar duke ngritur bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile dhe duke rritur kapacitetet organizative të organizatave përkatëse të shoqërisë civile.

Një iniciativë e OSBE-së përpiket të lehtësojë partneritetet dhe të identifikojë projektet ndërkufitare në zonën veriore të rajonit ndërkufitar.

Marrëveshja e parë e financimit për programin IPA bashkëpunimi ndërkufitar ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë-Shqipëri për vitin 2007 u nënshkrua në mars 2008 dhe zbatimi i saj do të fillojë së shpejti, me shpalljen e ftesës për propozime gjatë gjashtëmuajt të parë të 2009.

2.4.1. Mësimet e nxjerra

Pjesa më e madhe e iniciativave të filluara kohët e fundit, e bëjnë të parakohshme t'i përcaktojmë si “mësime të nxjerra”. Megjithatë, për t'u theksuar janë çështjet e mëposhtme:

- Pjesa më e madhe e projekteve të implementuara janë fokusuar në çështje të mbrojtjes së ambientit. Këto projekte reflektojnë prioritetet e përcaktuara nga institucionet kombëtare dhe

rajonale, duke kontribuar kështu për një përqendrim më të mirë në prioritetet e zhvillimit lokal dhe kombëtar. Megjithatë, është e rëndësishme të bashkëpunohet ngushtë me shoqërinë civile dhe sektorin privat në zhvillimin e programit. Duke lënë mënjanë disa paragjykime në lidhje me politikat për “qeverisjen formale” në projektet aktuale, ato sigurojnë një kuadër të mirë për zhvillimin e shoqërisë civile dhe partneriteteve të OJF-ve përgjatë kufirit.

- Ftesat e vogla për projektpropozime për projekte ndërkufitare të bëra treguan një kapacitet të ulët në përgatitjen e projekteve pothuajse të të gjithë përfituesve të fundit. Kjo mund të pengojë zbatimin e programit, sidomos në pjesën veriore ku nuk është zbatuar pothuajse asnjë iniciativë (me përjashtim të aksit Dibër-Peshkopi). Trajnime specifike për aplikantët potencialë do të shoqërojnë gjithë programin.

- Një numër i vogël bashkish kryesisht në zonën e jugut, kanë pasur një rol udhëheqës në iniciativat ndërkufitare të kaluara dhe të tanishme. Këto bashki duhet të kenë një rol kryesor gjatë implementimit të programit (transferimi i njohurive etj.).

- Ngritja e partneriteteve operacionale dhe të qëndrueshme do të jetë një sfidë për pjesën më të madhe të përfituesve. Një mbështetje e veçantë do të kërkohet me qëllim që të lehtësohet komunikimi dhe ngritja e partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare.

2.4.2 Koordinimi i donatorëve

Gjatë mbledhjeve të kaluara të Komitetit IPA, vendet anëtare të BE-së shprehën dëshirën që ambasadat e tyre, si dhe degët lokale të institucioneve ndërkombëtare financiare dhe shoqëria civile duhet të konsultohen mbi dokumentet e programimit IPA. Këto konsultime janë kryer tashmë në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë gjatë procesit të hartimit të MIPD 2007-2009.

Pas dërgimit të draftit të programit ndërkufitar në Komisionin European, delegacionet e qarkulluan atë në ambasadat e vendeve anëtare dhe zyrat lokale të institucioneve ndërkombëtare financiare në kryeqytetet e vendeve. Komentet e ardhura u morën parasysh në finalizimin e programit ndërkufitar.

2.5. Çështje horizontale

2.5.1. Shanse të barabarta dhe jo diskriminim

I kushtëzuar nga detyrimet ligjore në të dy vendet, programi do të sigurojë akses të njëjtë për aktivitetet e programit për të gjitha grupet e ndryshme të shoqërisë civile. Në veçanti, masa tre do të forcojë kohezionin social dhe shkëmbimet kulturore ndërmjet projekteve “njerëzit për njerëzit” dhe “Institucionet për institucionet” ndërmjet mbështetjes për integrim social për grupet e marginalizuara, të papunët, rininë rurale, forcën e punës të përfaqësuar nga gratë etj.

2.5.2. Mbështetje për minoritetet dhe grupet vulnerabile

Masa tre e prioritetit të parë ka për qëllim zhvillimin dhe implementimin e programit për integrimin social të grupeve vulnerabile, si të papunët, rininë rurale dhe forcën e punës të përfaqësuar nga gratë. Pjesa më e madhe e projekteve për t’u implementuar në kuadër të kësaj mase synojnë vlerësimin e karakteristikave multietnike të rajonit, duke i konsideruar ato si një pasuri për zhvillimin ekonomik dhe social. Për këtë arsye pjesëmarrja e minoriteteve dhe i grupeve vulnerabile në aktivitetet ndërkufitare do të inkurajohet fuqimisht.

2.5.3. Mbrojtja e ambientit

Masa dy e prioritetit të parë i dedikohet plotësisht mbrojtjes së ambientit. Qëllimi i aktiviteteve të propozuara do të jetë rritja e ndërgjegjësimit mbi çështjet e ambientit dhe inkurajimi i sektorëve privatë dhe bashkive të vogla për të marrë pjesë në mënyrë më aktive në dinamikën e filluar tashmë në një nivel institucional.

2.5.4. Mirëqeverisje, me një vëmendje të veçantë në luftën kundër korrupsionit

Veçanërisht në kuadër të masës së parë, por gjithashtu dhe në masat e tjera, do t’i jepet mbështetje zhvillimit të praktikave më të mira dhe planeve strategjike, transferimit të njohurive si dhe lehtësimit të bashkëpunimit ndërkufitar. Gjithashtu, masa dy do të stimulojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të ndryshme kombëtare dhe bashkiake për të hartuar politika mjedisore dhe programe pilot, ndërkohë që përfshirja e shoqërisë civile në këto aktivitete do të thellohet më tej.

2.6 Të dhëna

	2010	2011	2012
Numri i marrëveshjeve direkte të grantit në ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë	1	1	1
Numri i marrëveshjeve direkte të grantit në Shqipëri	1	1	1
Numri i ftesave të përbashkëta për projektpropozime të bëra	1	1	1
Niveli i kontraktimit (%) në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë	10 % (1)	100 %	100 %
Niveli i kontraktimit (%) në Shqipëri	10 % (1)	100 %	100 %

1) Në 2009 AT (€218 000) do të zbatohet nëpërmjet një marrëveshjeje direkte. Kjo është shpjeguar në dokumentin e programit CBC.

2.7. Hapat për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontrolle *ex ante* nga Komisioni

Një plan me etapat indikative dhe limiteve kohore për të realizuar decentralizimin pa kontrolle *ex ante* nga Komisioni do të hartohet menjëherë, pasi Komisioni t'ua ketë akorduar kompetencat menaxhuese autoriteteve kombëtare.

Për sa i përket procesit indikativ për decentralizimin pa kontrolle *ex ante* (sistemi i zbatimit të decentralizuar - DIS), situata është si në vijim:

Në rastin e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ngritja e një sistemi menaxhimi dhe kontrolli është vendosur nga qeveria në tetor 2005 dhe u rishikua në dhjetor 2006 në vijim të ndryshimeve në rregulloren IPA. Si hap i parë, pas ngritjes së strukturave të nevojshme organizative dhe administrative, u fillua një vlerësim i nevojave lidhur me decentralizimin e menaxhimit të fondeve të KE-së për t'u përshtatur me rregulloren e re të zbatimit IPA dhe rezultatet i janë paraqitur Komisionit. Një përditësim i vlerësimit të nevojave për t'u përshtatur me rregulloren e re të zbatimit IPA është përgatitur në gjysmën e dytë të vitit 2007 dhe në vijim të kësaj autoritetet kombëtare kanë dërguar një raport mbi vlerësimin e nevojave. Në vijim është bërë një analizë për plotësimin e nevojave gjatë gjysmës së dytë të vitit 2007/fillimi i 2008. Pas kryerjes së një vetëvlerësimi nga autoritetet kombëtare deri në prill 2008 për të kontrolluar që sistemi funksiononte ishte në përputhje me rregulloren IPA, faza e vlerësimit të përputhshmërisë e kryer nga një auditues i jashtëm filloi në gusht 2008 dhe përfundoi në dhjetor 2008 me konkluzione pozitive për sa i përket komponentit I, III dhe IV. Në vijim të përputhshmërisë së sistemit, zyrtari përgjegjës akreditues ka dërguar në Komision në janar 2009 aplikimin për aprovimin e menaxhimit.

Në Shqipëri Këshilli i Ministrave vendosi në shtator 2007 ngritjen e strukturave, autoriteteve dhe përgjegjësi për zbatimin e IPA-së në Sistemin e Zbatimit të Decentralizuar (DIS). Në nëntor 2007 Ministria e Financave i paraqiti propozimin për funksionimin e Njesisë Qendrore për Financim dhe Kontraktim (CFCU) Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerim. Një projekt i asistencës teknike nën IPA 2007 filloi aktivitetet në janar 2009. Plani indikativ i aktiviteteve të planifikuara të propozuara nga konsulencia e kontraktuar mund të jetë e ndarë në dy faza: në fazën e parë me zgjatje njëvjeçare, konsulencia do të mbështesë autoritetet shqiptare në rishikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e hapave të nevojshëm për një përgatitje të suksesshme për DIS nën komponentin I dhe II; në fazën e dytë, me zgjatje 6-mujore, konsulencia do të testojë si strukturat e ngritura dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e IPA-së për DIS dhe do të zhvillojë trajnime. Me fillimin e projektit, pala shqiptare u kërkua të miratojë një plan për DIS dhe të ngriejë Zyrtaret e Programeve SPOs në ministritë e linjës.

3. Buxheti i vitit 2009

3.1. Tabela financiare indikative për vitin 2009 për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

	Asistencë BE – IPA		Kontributi kombëtar		Total (IPA plus kontributi kombëtar)	
	EURO	%	EURO	(%)	EURO	(%)
Prioriteti 1	900,000	85	159,000	15	1,059,000	90
Prioriteti 2	100,000	85	18,000	15	118,000	10
TOTALI	1,000,000	85	177,000	15	1,177,000	100%

3.2. Tabela financiare indikative për vitin 2009 për Shqipërinë

	Asistencë BE – IPA		Kontributi kombëtar		Total (IPA plus kontributi kombëtar)	
	EURO	%	EURO	(%)	EURO	(%)
Prioriteti 1	765,000	85	135,000	15	900,000	90
Prioriteti 2	85,000	85	15,000	15	100,000	10
TOTALI	850,000	85	150,000	15	1,000,000	100%

3.3. Parimi i bashkëfinancimit i aplikueshëm për projektet të financuara nga programi

Kontributi i Komunitetit është përlogaritur në lidhje me shpenzimet e lejueshme, të cilat për programin ndërkufitar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë është bazuar në shpenzimet totale, siç është rënë dakord nga vendet pjesëmarrëse dhe përcaktuar në dokumentin e programit.

Aplikohen rregullat sipas nenit 90 të rregullores (EC) 718 datë 12.06.2007 (rregullorja e zbatimit IPA).

4. Marrëveshjet për implementimin

Të dy vendet do të menaxhojnë programin sipas modelit të menaxhimit¹ të centralizuar. Rregullat për implementimin e programit janë bazuar në principin e të dy vendeve përfutuese që janë partnerë të barabartë dhe kanë një rol të njëjtë në strukturat menaxhuese të programit ndërkufitar. Menaxhimi i përbashkët i programit do të sigurojë një zotërim lokal, përfshirje të gjerë, planifikim më të mirë dhe do të krijojë një bazë për aktivitete të sinqerta ndërkufitare.

4.1 Metoda e implementimit

Ky program do të implementohet në një bazë të centralizuar nga Komisioni European në përputhje me nenin 53/a të rregullores financiare² dhe që u përgjigjet rregullave të rregullores së zbatimit IPA³.

Në rast të menaxhimit të centralizuar roli i Komisionit në seleksionimin e projekteve në kuadër të një programi ndërkufitar ndërmjet vendeve përfutuese është përcaktuar në nenin 40 të rregullores së zbatimit IPA.

4.2. Rregulla të përgjithshme për prokurimin dhe procedurat e dhënies së grantit

Prokurimi do të ndjekë rregullat e përcaktuara në pjesën II, titulli IV të rregullores financiare, si dhe ato në pjesën II, titulli III, kapitulli 3 të rregullores së zbatimit, gjithashtu, dhe rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjeve, dhe punëve që financohen nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane për qëllimet e bashkëpunimit me vendet e treta aprovuar nga Komisioni më 24 maj 2007 (C(2007)2034).

¹ Për të dyja vendet qëllimi është menaxhim i decentralizuar. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është në proces të përgatitjes së akreditimit të strukturave menaxhuese. Ky proces pritet të përfundojë në vitin 2009 dhe më pas vendi do të aplikojë një model të menaxhimit të decentralizuar në 2010. Një proces i ngjashëm ka nisur gjithashtu në Shqipëri.

² OJ L 248, 16.9.2002, faqe1.

³ OJ L 357, 31.12.2002, p. 1.

Procedurat e dhënies së grantit do të ndjekin rregullat e pjesës së parë, titulli VI në rregulloren financiare dhe pjesën e parë, titulli VI në rregulloren e zbatimit.

Sipas rastit, autoritetet kontraktuese do të përdorin gjithashtu formatin standard dhe modelet që lehtësojnë aplikimin e rregullave të mësipërme, të cilat ndodhen në “Udhëzuesin praktik të procedurave të kontraktimit për veprimet e huaja të KE-së” (Udhëzuesi praktik), publikuar në faqen e internetit të EuropeAid¹ në ditën e fillimit të procedurave të prokurimit dhe dhënies së grantit.

4.3. Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe mbrojtja e natyrës (në raste të nevojshme)

Të gjitha investimet do të realizohen në përputhje me legjislacionin përkatës të Komunitetit mbi mjedisin dhe të sigurojnë një aplikim të parimeve europiane për mjedisin².

Procedurat për vlerësimin e rolit të mjedisit si janë përcaktuar në direktivën EIA³ aplikohen tërësisht për të gjitha projektet e investimeve nën instrumentin IPA. Nëse direktiva EIA nuk është transpozuar ende plotësisht, procedurat do të jenë të ngjashme me ato të përcaktuara në direktivën e sipërpërmendur.

Nëse një projekt ka të ngjarë të ketë ndikim në vendet me rëndësi për ruajtjen e natyrës, një vlerësim i saktë i ruajtjes së natyrës duhet të bëhet, ekuivalente me atë të nenit 6 të direktivës së habitatit, dhe duhet të dokumentohet⁴.

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1. Monitorimi

Implementimi i programit ndërkufitar do të monitorohet nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, të ngritur nga vendet përfituese, dhe që përfshin dhe përfaqësues të Komisionit, sipas nenit 142 të rregullores së zbatimit IPA.

Në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Shqipëri, Komisioni mund të ndërmarrë çdo aksion që lind i nevojshëm për të monitoruar programin në fjalë.

5.2. Vlerësimi

Programet do të jenë subjekt për vlerësim në përputhje me nenin 141 të rregullores së zbatimit IPA, me qëllim që të përmirësojë cilësinë, efektivitetin dhe përputhshmërinë e asistencës nga fondet e Komunitetit dhe strategjinë e implementimit të programeve ndërkufitare.

6. Auditimi, kontrolli financiar, masat antimashtrim

Llogaritë dhe aktivitetet e të gjitha palëve të përfshira në implementimin e këtij programi, si dhe të gjitha kontratat dhe marrëveshjet që implementojnë këtë program, janë subjekt, nga njëra anë, i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të Komisionit (duke përfshirë edhe Zyrën Europiane të Antimashtrimit), të cilat mund të zhvillojnë kontrolle, kur e gjykon të arsyeshme, ose vetë ose nëpërmjet një audituesi të jashtëm, nga ana tjetër, audituesve nga Gjykata Europiane e Llogarive. Kjo përfshin masa të tilla si p.sh. verifikimin *ex ante* të tenderimit dhe kontraktimit të zhvilluara nga delegacionet e vendeve përfituese.

Me qëllim për të siguruar një mbrojtje efikase të interesave financiare të Komunitetit, Komisioni (duke përfshirë Zyrën Europiane të Antimashtrimit) mund të ushtrojë kontrolle në vend dhe inspekte, në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96⁵.

Kontrollet dhe auditivet e përshkruara më lart janë të aplikueshme për të gjithë kontraktuesit, nënkontraktuesit dhe përfituesit e grantit, të cilët kanë përfituar fonde nga Komuniteti.

7. RIAKORDIMET JOTHELBËSORE TË FONDEVE

Zyrtari i autorizuar me delegim (ZAD) ose zyrtari i autorizuar me nëndelegim (ZAND), në pajtim me kompetencat që i delegohen atij nga ZAD dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, mund të kryejë riakordim të fondeve jothelbësore pa qenë nevoja e një vendimi financiar amendues. Në këtë kontekst, fonde jothelbësore quhen riakordimet kumulative që nuk

¹ Adresa aktuale: http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical_guide/index_en.htm

² Shiko <http://eib.org/infocentre/epe>

³ Direktiva e Këshillit 85/337/EEC datë 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (OJ L 175, 5.7.1985, faqe 40).

⁴ Direktiva e Këshillit 92/43/EEC datë 21 maj 1992 mbi mbrojtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër (OJ L206, 22.7.1992).

⁵ Rregullorja e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96 datë 11 nëntor 1996, OJ L 292; 15.11.1996; faqe 2.

tejkalojnë 20% të shumës totale të akorduar për programin dhe as tavanin 4 milionë euro, me kusht që këto riakordime të mos cenojnë natyrën dhe objektivat e programit. Komitetit i IPA-së duhet të informohet për riakordimet e përmendura më lart.

8. NDRYSHIME TË KUFIZUARA NË ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ndryshimet e kufizuara në zbatimin e këtij programi që prekin elementet me natyrë indikative¹ të renditura në nenin 90 të rregullave zbatuese të rregullores financiare. mund të ndërmerren nga zyrtari i autorizuar me delegim, (ZAD) ose nga zyrtari i autorizuar me nëndelegim (ZAND), në pajtim me kompetencat që i delegohen atij nga ZAD dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, pa qenë nevoja për një vendim financimi amendues.

VENDIM

Nr.818, datë 13.10.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1691, DATË 10.10.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR PREFEKTËT NË QARQE DHE
ADMINISTRATËN E PREFEKTËVE, NËNPREFEKTËT DHE ADMINISTRATËN E
NËNPREFEKTËVE DHE PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË EMERGJENCAVE
CIVILE (DREJTORISË SË PMNZSH-SË)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lista me 2 (dy) fletë, për prefektin e qarkut të Beratit dhe administratën e tij, me 10 (dhjetë) prona, që i bashkëlidhet vendimit nr.1691, datë 10.10.2007 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me listën me 2 (dy) fletë, për prefektin e qarkut të Beratit dhe administratën e tij, me 10 (dhjetë) prona, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe prefekti i qarkut të Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

¹ Këto elemente thelbësore me natyrë indikative janë: për grantet, shuma indikative e thirrjes për propozime, ndërsa për prokurimet, numri indikativ dhe tipi i kontratave të parashikuara, si dhe afati kohor indikativ i parashikuar për shpalljen e procedurave të prokurimit.

VENDIM
Nr.819, datë 13.10.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIMI I BLOKUT NR. 2,
NË BASHKINË E DELVINËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi i bllokut nr.2, në bashkinë e Delvinës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Delvinës.
3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 100 m² tokë truall, pronë private që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë, pronë private të të cilëve shpronësohen, është 263 800 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekë.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Delvinës, planifikuar në buxhetin e saj.
6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Delvinës.
8. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Delvinës, për realizimin e këtij projekti.
9. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 100 m² tokë/truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Delvinës, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Delvinës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR “SISTEMIMIN E BLOKUT NR.2”, NË BASHKINË E DELVINËS**

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. m² truall	Çmimi lekë/m²	Vlera lekë	Dokumenti i pronësisë	Zona kadastrale
1	Vaide Berberi	20	2638	52760	Vërt. pronësie	1464
2	Myzafer Berberi	20	2638	52760	Vërt. pronësie	1464
3	Arta Berberi	20	2638	52760	Vërt. pronësie	1464
4	Ludmilla Berberi	20	2638	52760	Vërt. pronësie	1464
5	Nardi Berberi	20	2638	52760	Vërt. pronësie	1464
	Totali	100		263800		

VENDIM
Nr.820, datë 13.10.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Lista me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 10.11.2010

Doli nga shtypi më 12.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë